



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 57, Datë 12/07/2017

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 114, datë 05.12.2016, e znj. S.L., e cila pretendon diskriminim, nga ana e Komisariatit Nr. 3, Tiranë; Prokurorisë së Rrethit Tiranë; Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë së Policisë Tiranë, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Ankuesja S.L., lindur në Burrel, më 05.04.1983 dhe banuese në qytetin e Tiranës, mbështetur në librezën “Për përfituesit e statusit të invalidit”, nr. 00078, me nr. personal 135405140V, është diagnostikuar si Tetraplegjike e Grupit të 1-ë, të invaliditetit. Për shkak të pamundësisë për të ecur, ajo përdor karrocë me rrota.

Duke filluar nga data 27 tetor 2016, ankuesja i është drejtuar për informacion Komisariatit Nr. 3 Tiranë; Prokurorisë së Rrethit Tiranë; Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm¹ dhe Drejtorisë së Policisë Tiranë, në ndjekje të një çështjeje familjare, por asnjë prej këtyre institucioneve nuk kishte kushte të përshtatshme për të mundësuar lëvizjen lirshëm me karrocë për personat me aftësi të kufizuar. Për këtë arsye, i është dashur të shoqërohet nga persona të tretë, të cilët e kanë ngritur në krah. Znj. S.L. shpjegon në ankesë se me përjashtim të Drejtorisë së Policisë Tiranë, e cila ka një rampë, por edhe kjo tepër e pjerrët dhe e rrezikshme, asnjë prej institucioneve të sipërcituara nuk siguron as kushtet më minimale të marrjes së shërbimit për këtë kategori personash, siç janë, përveç rampës, edhe tualetet e ashensorët. Për të zgjidhur problemin për të

¹ Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat është i lokalizuar me zyra pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme

cilin ishte paraqitur në këto institucione, asaj i është ofruar shërbimi nëpër korridore dhe jo në zyrat përkatëse, pasi nuk kishte mundësi lëvizjeje me ashensorë.

Për sa më sipër, ankuesja S.L. pretendon se situata e krijuar e ka vendosur në pozita diskriminuese, në raport me personat e tjerë.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Pas analizimit të ankesës nr. 114, datë 05.12.2016, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

2. Mbështetur në nenin² 33, pika 7, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri iu drejtua zyrtarisht institucioneve kundër të cilëve drejtohej ankesa, si më poshtë:

- Me shkresë nr. 1206 prot, datë 30.12.2016, Komisioneri iu drejtua Prokurorisë së Rrethit Tiranë, Drejtorisë së Policisë Tiranë, Komisariatit Nr. 3 Tiranë dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të cilëve iu kërkua informacion i detajuar në lidhje me përshtatshmërinë logjistike të institucioneve (rampë, ashensorë, tualete etj) për të pritur persona me aftësi të kufizuara dhe planin e investimeve, për të verifikuar nëse ngritja dhe përmirësimi i infrastrukturës në ndihmë të këtij grupi, është parashikuar si zë i vecantë në buxhet.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, subjektet e mësipërme kanë vënë në dispozicion aktet e mëposhtme:

- Shkresë nr. 792 prot, datë 24.01.2017 e Prokurorisë, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, “Për mosfillimin e procedimit penal”, lidhur me kallëzimin e bërë nga shtetësja Nensi S.L..
- Shkresë nr. 111/1 prot, datë 26.01.2017 e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, “Kthim përgjigje”, ku sqarohet se në “*Ambientet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku është lokalizuar ky Shërbim, pas rikonstruksionit të fundit është hapur një zyrë e vecantë e pritjes së qytetarëve, që ofron shërbimin nga ora 8.00-20.00*”. Sipas kësaj shkrese, bëhet me dije gjithashtu se qytetarët që kanë një ankesë apo denoncim, mund të kontaktojnë edhe në linjën e gjelbër 0800 90 90.
- Shkresë nr. 22/1 prot, datë 10.01.2017 e Komisariatit të Policisë, Nr. 3 Tiranë, ku informohet se “*Komisariatit i Policisë Nr. 3 Tiranë, ka deri diku kushte të përshtatura për të pritur personat me aftësi të kufizuara. Ekzistojnë tualete të nevojshme dhe salla e*

²Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

pritjes, por mungon ndërtimi i një rampe që mundëson hyrjen e personave me aftësi të kufizuar në ambientet e brendshme të institucionit”. Sipas kësaj shkrese, “Në të ardhmen është planifikuar kryerja e investimeve rikonstruktuese dhe do të sugjerohet nga ana e titullarit të institucionit ndërtimin i rampave të nevojshme për të bërë të mundur aksesimin edhe nga personat me aftësi të kufizuara”.

3. Në vijim të procedurave hetimore, në zbatim të Urdhrit nr. 7, datë 24.01.2017 të Komisionerit, më datën 30.01.2017, në strukturat e sipërpërmendura u zhvillua inspektimi, me objekt:

- Kryerja e verifikimeve për përshtatshmërinë logjistike të këtyre institucioneve, për të pritur persona me aftësi të kufizuar;
- Verifikimin e planit të investimeve për ngritjen e infrastrukturës, për këtë kategori personash;
- Administrimin e akteve, që kanë lidhje me çështjen në fjalë.

Mbështetur në proceverbalin e inspektimit të zhvilluar në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, Inspektorët e Komisionerit morën kontakt me Sekretarinë e Prokurorisë, ku u bënë me dije se *për shkak të kohës³, urdhri i inspektimit nuk ishte shqyrtuar ende nga titullari, ndaj ende nuk ishte ngarkuar një person përgjegjës për zbatimin e tij. Për këtë arsye, u ra dakord që Komisioneri të kontaktohej për ta zhvilluar inspektimin në një prej ditëve në vijim⁴. Me gjithë kohën e lënë në dispozicion, Komisioneri nuk u kontaktua nga ana e Prokurorisë, në asnjë prej ditëve në vazhdim. Inspektorët e KMD bënë vetëm verifikime të jashtme dhe konstatuan se ambientet e këtij institucioni janë të përshtatura me ashensor, ndërsa në hyrje të tij nuk ka rampë, fakt që pamundëson marrjen e shërbimit për atë kategori personash që përdorin karrocë me rrota.*

Në vijim të procedurave të inspektimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, inspektorët morën kontakt në telefon me Shefin e Seksionit Ekonomik, i cili *kërkoj kohë për përgatitjen e përgjigjes shkresërisht, në lidhje me kërkesat e përcaktuara në urdhrin e inspektimit. Nga shqyrtimi i provave rezulton se Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, nuk ka depozituar asnjë përgjigje në lidhje me objektin e mësipërm. Nga verifikimi i jashtëm që bënë inspektorët e Komisionerit, u konstatua se hyrja e jashtme e institucionit është e përshatur me rampë dhe kushtet e pritjes dhe marrjes së ankesave të publikut janë të përshtatura për çdo kategori, ndërsa në ambientet e brendshme, nuk ka akses me ashensor.*

Në inspektimin e realizuar në Komisariatit Nr. 3 Tiranë, inspektorët u takuan me znj. A. B, Shefe e Seksionit të Shërbimit Mbështetës. Sipas sqarimeve të dhëna prej saj, *plani i investimeve të Komisariatit nr. 3, Tiranë, varet nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë (institucioni nga i cili varen), ndaj kërkesa për shtimin e investimeve, me qëllim përshtatshmërinë e ambienteve të institucionit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, është parashtruar si kërkesë nga*

³ Sipas Sekretarisë së Prokurorisë së Rrethit Tiranë, shkresa përcjellëse bashkëlidhur Urdhrin e inspektimit të Komisionerit, ishte protokolluar më datën 25.01.2017, me nr. 895.

⁴ Komisioneri nuk u kontaktua më pas nga Prokuroria për një inspektim të dytë.

ana e këtij institucioni, i cili mbetet në pritje për përmbushjen e saj. Nga verifikimet e kryera rezulton se ky Komisariat nuk ka kushte të përshtatura as në hyrje dhe as në ambientet e brendshme të tij. Konkretisht, nuk ka rampë, nuk ka ashensor dhe as tualete, që i vijnë në ndihmë plotësisht të nevojave për personat me aftësi të kufizuara.

Në inspektimin e realizuar në Drejtorinë e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe nga kontakti i marrë me z. S. Gj, Shef i Sektorit të Inspektimit, u bë me dije se ky Shërbim e ushtron aktivitetin e tij pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, në ambientet e së cilës është edhe “Zyra e ankesave”. Lidhur me planin e investimeve dhe përshtatshmërinë e kushteve logjistike për personat me aftësi të kufizuara, bëhet me dije se godina ku e zhvillon aktivitetin kjo drejtori, nuk është nën administrimin e saj. Për këtë arsye nuk mund të ndërhyjë me investime, për përshtatshmërinë e kushteve për personat me aftësi të kufizuara.

Në përfundim të procesit të inspektimit, mbështetur në provat e administruara nga palët në këtë proces dhe verifikimet e drejtëpërdrejta të kryera nga inspektorët e Komisionerit, rezultoi se:

- Vetëm Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ka infrastrukturë të jashtme të përshtatur, në ndihmë të personave me aftësi të kufizuara, po ashtu ka siguruar kushte të brendshme të marrjes së ankesave.
- Prokuroria e Rrethit Tiranë edhe pse ka në shërbim të saj ashensor të brendshëm, kjo nuk përbën provë bindëse se mjeti është vënë në dispozicion për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, më shumë sesa për faktin se është ndërtesë shumëkatëshe. Mungesa e rampës, në hyrje të institucionit e provon këtë argument.
- Komisariati nr. 3 Tiranë dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, megjithëse janë institucione të ristrukturuara, nuk kanë marrë në konsideratë që të sigurojnë përshatatshmëri të kushteve për individë me nevoja të veçanta, sic janë personat me aftësi të kufizuara.
- Asnjë prej institucioneve të sipërcituara, nuk i është përgjigjur shkresës nr. 1206 prot, datë 30.12.2016, të Komisionerit, për informacion në lidhje me: *“Planin e investimeve, për ngritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës (rampë, ashensorë; tualete etj), në ndihmë të pritjes së personave me aftësi të kufizuara”*.

Gjatë inspektimit të kryer nga Komisioneri, institucionet kërkuar kohë për depozitimin e akteve, por nga provat e shkresore rezultoi se asnjë prej tyre nuk ka kthyer përgjigje⁵. Mungesa e këtij plani si provë shkresore, krijon bindjen se asnjë nga këto institucione nuk ka parashikuar investim konkret për përshtatshmërinë e kushteve infrastrukturore për personave me aftësi të kufizuara.

Për sa më sipër, mbështetur në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me*

⁵ Bën përjashtim Drejtoria e Shërbimit për Çështjet e Brendshme, e cila pritej të zhvendosej nga ambientet e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe për pasojë nuk kishte akses në investime, brenda këtij institucioni.

gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”. Nga parashikimet e këtij neni, aftësia e kufizuar është shkak i mbrojtur, të cilit i shtohet edhe ndalimi i diskriminimit në rastin kur kësaj kategorie i mohohet e drejta e përshtatjes së arsyeshme, për akses të barabartë në shërbime, parashikuar në nenin 3 pika 7 konkretisht: “Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji”, si dhe në dispozitat e nenit 5 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë; 2. Mohimi i modifikimeve dhe përshtatjeve të duhura e të nevojshme për personat me aftësi të kufizuara”.

Kjo e drejtë sanksionohet e përforcuar si një ndër parimet bazë të ligjit nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, shprehimisht në nenin 4 të tij:

“Parimet bazë të këtij ligji janë:

- a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;
- b) barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta;
- c) autonomia e personave me aftësi të kufizuara dhe respektimi i pavarësisë së vendimmarrjes së personave me aftësi të kufizuara;
- ç) garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanim të pengesave të të gjitha llojeve; Perditesuar dhe Dixhitalizuar nga Qendra për Qeshtjet e Informimit Publik, INFOÇIP www.infocip.org ; www.vendime.al
- d) përfshirja, nëpërmjet së cilës mundësohet pjesëmarrja e duhur dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës;
- dh) pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet konsultimit individual dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara;
- e) qasja në dy drejtime, për të integruar në maksimum të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në legjislacionin e zakonshëm dhe për t'i kufizuar në minimum çështjet që duhen trajtuar më vete;
- ë) realizimi progresiv, sipas të cilit Qeveria ndërmerr masa për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, që e lejojnë

burimet e disponueshme, pa cenuar të drejtat e fituara, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Për sa më sipër, mbështetur në parashikimet e nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i cili sanksionon se: “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”, Komisioneri vlerëson se mungesa e infrastrukturës së nevojshme nga ana e institucioneve të mësipërm, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të ushtrojnë lirisht të drejtën për të marrë shërbime pranë këtyre institucioneve, është bërë shkak për ekspozimin e ankueses S.L. dhe të cdo personi tjetër që e përket kësaj kategorie, përballë faktit të diskriminimit dhe trajtimit të pabarabartë, në raport me personat e tjerë.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, Komisioneri gjykon se nga ana e Prokurorisë së Rrethit Tiranë; Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Komisariati Nr. 3 Tiranë, duhet të ishin marrë të gjitha masat që personave me aftësi të kufizuara t’u krijoheshin kushtet e përshtatshme për të aksesuar në mënyrë të barabartë me të tjerët ambjentet e këtyre institucioneve.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 2, 3, pika 1 dhe pika 7, nenin 4, pika 2, neni 7, pika 1, nenin 20, nenin 32, pika 1, gërma b), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, të ankueses S. L. dhe të të gjithë personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Tiranë; Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Komisariati Nr. 3 Tiranë.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa konkrete dhe të menjëhershme nga ana e Prokurorisë së Rrethit Tiranë; Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Komisariati Nr. 3 Tiranë, për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme: rampë, tualete dhe ashensorë, në rastet kur ky i fundit është i nevojshëm, me qëllim sigurimin e aksesit dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.
3. Brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Prokuroria e Rrethit Tiranë; Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë dhe Komisariati Nr. 3 Tiranë, të njoftojnë Komisionerin, lidhur

me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda afateve të parashikuara me ligj.

KOMISIONERI

IRMA BARAKU

Shkak – aftësia e kufizuar
Fusha – Të mira dhe Shërbime
Lloji i vendimit - Diskriminim